

UDHËZIM
Nr. 6/3, datë 8.4.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 13.5.2008, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 19.4, paragrafi 1 zëvendësohet me këtë përmbajtje:
“1) Shpenzimet e karburantit, përveçse kur qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e karburantit me qëllim për ta shitur atë.

Për qëllime të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, kreditimi i TVSH-së së gazoilit të blerë për këtë qëllim, është i lejueshëm deri në normativat e listuara më poshtë, mbi bazën e treguesit të përcaktuar sipas peshës specifike që blerjet për gazoil zënë në raport me qarkullimin e kryer për qëllime të veprimtarisë ekonomike.

Normativat e kreditimit të TVSH-së së gazoilit

I. Ndërtim

- a) Prodhim materiale inerte deri më 33%;
- b) Ndërtim shtrim rrugësh deri më 32%;
- c) Ndërtim banesash dhe objektsh të ndryshme deri më 8%;
- ç) Prodhim betoni deri më 14%;
- d) Gërmime/shpime deri më 25%;
- dh) Prodhim tullash dhe tjegullash 33%.

II. Transport

- a) Transport udhëtarësh deri më 43%;
- b) Transport mallrash deri më 38%;
- c) Transport mallrash me mjete teknologjike 78%.

III. Shërbime

- a) Autoshkolla deri më 25%;
- b) Shërbime pastrimi qyteti deri më 30%;
- c) Peshkimi deri më 10%.

III. Tregti deri më 3%

IV. Të tjera (të palistuara më lart) deri më 2%

Barra e provës për të provuar qëllimin e përdorimit të gazoilit për qëllime të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, bie mbi personin e tatueshëm.

Nëse nga kontrolli i thelluar konstatohet që personi i tatueshëm me pa të drejtë ka kredituar TVSH-në lidhur me blerjen e gazoilit, duke mos e justifikuar atë, Drejtoria Rajonale Tatimore aplikon të gjitha sanksionet që parashikon legjislacioni tatimor në fuqi.”.

2.Pika 19.5 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

Botuar ne F.Zyrtare 47 / 2014
Dale nga shtypi me 09.04.2014